



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 772/ 10prot.

Datë 03.05.2024

V E N D I M

Nr. 443/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.05.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 395/2024, datë 23.04.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-99251-03-25-2024, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime”, me fond limit 1,333,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prenjas.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë: Rruga “Fortuzi”, 66/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Prenjas
Rruga “Skënderbej”, godina 15, Prenjas.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 23.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 395/2024, ku vendosi:
[...]

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-99251-03-25-2024, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime”, me fond limit 1,333,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryeje modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies ” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.1283/1 prot., datë 30.04.2024, protokolluar me tonën nr. 772/7 prot., datë 02.05.2024 autoriteti kontraktor, kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës në lote në zbatim të vendimit nr. 395/2024, datë 23.04.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.1283/1 prot., datë 30.04.2024, protokolluar me tonën nr. 772/7 prot., datë 02.05.2024 autoriteti kontraktor, kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës në lote në zbatim të vendimit nr. 395/2024, datë 23.04.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor kërkon heqjen e procedurës nga pezullimi për të bërë anulimin dhe për të vijuar më tej me rihedhjen e procedurës në lote, në zbatim të vendimit nr. 395/2024, datë 23.04.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-99251-03-25-2024, me objekt “Blerje kancelari dhe shtypshkrime”, me fond limit 1,333,250 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrenjas.
2. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të reflektojë në dokumentet e tenderit arsyetimet dhe konstatimet e vendimit nr.395/2024 datë 23.04.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

